

	- Bashkia Korçe Projekti "Qendra ditore për moshën e tretë"	2000	2000	0	100
	- Shoqatat e të verbërve	870	286	584	32.87
	- Sherbimi i kujdesit Paliativ Korçe	400	400	0	100
	Investime kapitale	17307	0	17307	0
	Nga keto:				
	Investime të institucionit	2840	0	2840	0
	Investime në infrastrukturë për bashkitë e qarkut	14467	0	14467	0
<b>2</b>	<b>Drejt.DAMT –Programi 01160</b>	<b>4701</b>	<b>4222</b>	<b>479</b>	<b>89.8</b>
	Paga personeli	3838	3499	339	91.2
	Sigurime shoqërore e shëndetsore	585	584	1	100
	Shpenzime operative	278	139	139	50
<b>3</b>	<b>Bashkefinancim në Projekte me fonde Bashkimit Europian- Programi 08250</b>	<b>40904</b>	<b>0</b>	<b>40904</b>	<b>0</b>
<b>4</b>	<b>Fondi rezerve – Programi 04980</b>	<b>500</b>	<b>0</b>	<b>500</b>	<b>0</b>
	<b>Total KESHILLI I QARKUT</b>	<b>97428</b>	<b>29197</b>	<b>68231</b>	<b>30</b>

#### **Analiza analitike e shpenzimeve për 8-mujorin e vitit 2018, (për Administratën)**

Buxheti i periudhës 8/mujore për administratën e Keshillit të Qarkut është realizuar në nivelin **48.66 %** dhe në vlerë absolute **24975 mijë** leke nga **51323 mijë** leke të programuara. Menaxhimi i buxhetit për këtë periudhë është bërë sipas programeve të miratuara në planin fillestar dhe ndryshimet përkatëse, duke ruajtur një raport të drejtë ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve, si dhe duke patur një bilanc pozitiv të pagesave brenda limiteve të miratuara nga Keshilli i Qarkut.

Duke analizuar në mënyrë analitike sipas strukturave përdorimi i fondeve për shpenzime që ka patur në dispozicion administrata e Keshillit të qarkut gjatë 8 mujorit viti 2018 rezultoi si më poshtë:

- Shpenzimet korentë për Administratën janë realizuar në nivelin 24975 mijë leke ose 73.4 % ndaj 34016 mijë leke sipas programit buxhetor për 8/mujorin. Ecuria e shpenzimeve korentë ka qenë në përputhje të drejtë për çdo muaj duke përmbushur të gjitha nevojat dhe detyrimet për funksionimin normal të Administratës.
- Shpenzimet kapitale janë në nivelin zero për arsye që përmendëm më lart.

#### **a. Shpenzime për Paga dhe Sigurimet Shoqërore të Punonjësve (Artikulli 600+601)**

Realizimi i shpenzimeve për paga dhe sigurime shoqërore si 8 muaj viti 2018 për personelin është kryer në zbatim të strukturës organike të miratuar nga Keshilli i Qarkut. Administrata përbehet nga 13 punonjës, të cilët paguhen në nivelin e pagave të miratuara në Keshillin e Qarkut. Fondet për financimin e këtyre shpenzimeve janë nga Transferata e Pakushtëzuare vitit 2018 si dhe pjesërisht nga të ardhurat e trashëguara. Realizimi i fondit të pagave dhe sigurimeve shoqërore për 8 muajorin vitin 2018 është në vlerën **11801 mijë leke** ose **82 %** ndaj **14500 mijë** leke të miratuara sipas programit. Në këtë mosrealizim ka ndikuar përfundimi parakohe i pagesës në listen e pritjes për një punonjëse si dhe mospërdorimi i fondit të vecantë të miratuar për këtë periudhë.